

Vendim nr. 324, datë 05.12.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 05.12.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 26 (Sh) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “FEDOS” SH.P.K., përfaqësuar nga avokat Agim Bega.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-2925, datë 22.07.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shoqëria “Fedos” sh.p.k. ushtron aktivitetin tregtar në fushën e pajisjeve mjekësore. Në datën 04.10.2024 Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale (*Autoriteti Kontraktor*) ka publikuar procedurën e prokurimit nr. ref. -22509-10-02-2024, me objekt “*Lot. 7 “Drug-eluting stent for restenosis- stenta të medikuara për restenozë”*”, me fond limit 158,026,510.00 lekë pa TVSH. Për këtë procedurë prokurimi kanë paraqitur ofertë kërkuësja dhe Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë i përbërë nga shoqëritë “O.E.S. Distrimed” sh.p.k. dhe “Montal” sh.p.k. (*bashkimi i operatorëve ekonomikë*).

2. Në datën 06.12.2024 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (*KVO*) pranë Autoritetit Kontraktor ka bërë klasifikimin e ofertuesve pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, duke skualifikuar kërkuesen dhe kualifikuar bashkimin e operatorëve ekonomikë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuësja. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pranë Autoritetit Kontraktor, me vendimin nr. 76/6, datë 21.01.2025, ka vendosur ta pranojë pjesërisht atë, por pa e ndryshuar gjendjen juridike të kërkueses, e cila ka mbetur e skualifikuar për shkak të mospërmbushjes të të gjitha kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Për pjesën e pranuar të ankesës ka paraqitur ankesë bashkimi i operatorëve ekonomikë.

3. Komisioni i Prokurimit Publik (*KPP*), pas shqyrtimit të ankesave të pjesëmarrësve në këtë procedurë prokurimi, me vendimin nr. 529/2025, datë 17.04.2025 (*vendimi nr. 529/2025*), ka vendosur: (i) të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së kërkueses; (ii) të pranojë ankesën e kërkueses në procedurën e prokurimit; (iii) të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit; (iv) autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e kërkueses, duke e kualifikuar atë. Në zbatim të këtij vendimi kërkuësja është kualifikuar nga Autoriteti Kontraktor për vijimin e procedurës.

4. Në këto kushte, bashkimi i operatorëve ekonomike ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Apelit kërkesë për marrjen e masës së sigurimit të padisë, regjistruar më 24.04.2025, duke kërkuar pezullimin e procedurës së konkurrimit dhe të efekteve të vendimit nr. 529/2025 të KPP-së deri në përfundimin e procesit të themelit.

5. Po kështu, bashkimi i operatorëve ekonomikë i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit edhe me kërkesëpadi, me objekt: (i) shfuqizimin e vendimit nr. 529/2025 të KPP-së; (ii)

shfuqizimin e vendimit nr. 76/6, datë 21.01.2025 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave; (iii) skualifikimin e kërkueses nga procedura e prokurimit; (iv) detyrimin e Autoritetit Kontraktor për vijimin e procedurës. Për rrjedhojë, në Gjykatën Administrative të Apelit është regjistruar çështja nr. 31154-01405-86-2025, në datën 06-05-2025, me objekt dhe palë si më sipër.

6. Për kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të padisë të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 48 (86-2025-912), datë 05.05.2025, ka vendosur rrëzimin e saj. Sipas saj, kërkesa lidhet me vlefshmërinë e vendimmarrjes së KPP-së që është çështje e cila qëndron në themel të shqyrtimit gjyqësor dhe, si e tillë, nuk mund të jetë objekt i kërkesës për sigurim padie. Për më tepër, ajo gjykatë ka vlerësuar se vendimmarrja e KPP-së nuk është vendim për përfundimin e procedurës së konkurrimit që të mund të krijonte pritshmëri të ligjshme, për rrjedhojë nuk mund të pretendohet një dëm ekonomik i pësuar nga procedura. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs të veçantë bashkimi i operatorëve ekonomikë.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-2925, datë 22.07.2025, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit, duke pranuar kërkesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë për marrjen e masës së sigurimit të padisë, konkretisht për pezullimin e procedurës së konkurrimit dhe të efekteve të vendimit nr. 529/2025 të KPP-së deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes me vendim të formës së prerë. Kolegji Administrativ ka vlerësuar se gjykata e apelit nuk ka interpretuar drejt dispozitat procedurale për kriteret për vendosjen e masës së sigurimit dhe nuk ka analizuar siç duhet një nga kushtet thelbësore për vendosjen e masës, ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, duke e bërë atë të cenueshëm.

8. Në datën 01.10.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkueses

9. *Kërkuësja*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

- 9.1.1. *E drejta për t'u mbrojtur e dëgjuar dhe parimi i kontradiktoritetit*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka përfshirë kërkuesen si palë ndërgjyqëse nga pikëpamja formale, nuk e ka njoftuar për zhvillimin e gjykimit dhe as nuk i ka dhënë mundësinë të shprehej për atë që kërkohej.
- 9.1.2. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi analiza e Gjykatës së Lartë është e njëanshme. Në arsyetimin e atij vendimi është theksuar fakti i një dëmi të rëndë që mund t'i shkaktohet palës tjetër, duke mos argumentuar dëmin e ardhur kërkueses me mospërfaqësimin e saj në proces. Ajo gjykatë jo vetëm që ka analizuar atë që është kërkuar në padinë e themelit, por edhe ka treguar qartë që ka mbrojtur interesat e njëres palë, ndërkohë që kërkuesen nuk e ka përmendur fare në arsyetim.
- 9.1.3. *Standardi i arsyetimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë e ka mbështetur arsyetimin e saj mbi fakte e argumente krejt të pambështetura në ligj, pasi në tagrin e saj nuk hyn vlerësimi i provave. Arsyetimi i saj bie ndesh me ligjin procedural dhe me vetë praktikën e Kolegjit Administrativ, pasi i mungon kompetenca funksionale. Edhe dispozitivi i vendimit paraqet problematika, pasi në të nuk është përcaktuar se në çfarë mënyre duhet të bëhet sigurimi i padisë, duke e bërë vendimin edhe të paekzekutueshëm.
- 9.2. *E drejta e pronës private*, për shkak të procesit jo të rregullt ligjor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me

shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Në drejtim të verifikimit të kriterëve, si më sipër, Kolegji vlerëson se kërkesja, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, sepse është palë e paditur në procesin gjyqësor të themelit, në funksion të të cilit është vendosur masa e sigurimit të padisë, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore të ndërmjetme, nëse plotësohen njëherazi tre kushte: (i) kur shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm; (ii) vendimi i ndërmjetëm të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe gjykatat më të larta të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; (iii) vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Kolegji vëren se kërkesja ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, e cila ka disponuar për pranimin e kërkesës së palës tjetër ndërgjyqëse për marrjen e masës për sigurimin e padisë për pezullimin e procedurës së konkurrimit dhe të efekteve të vendimit nr. 529/2025 të KPP-së, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes me vendim të formës së prerë. Në lidhje me vendimet gjyqësore për sigurimin e padisë, Gjykata ka pohuar se ato edhe kur e pranojnë kërkesën, nuk janë përfundimtare në lidhje me të drejtat themelore. Ato janë masa të përkohshme të marra gjatë procedurës së themelit të çështjes dhe nuk konsiderohen si një procedurë e veçantë, e ndarë nga ajo kryesorja (*shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në këndvështrim të elementeve që shqyrtohen për të përcaktuar natyrën e vendimeve të ndërmjetme për qëllime të kontrollit kushtetues, Kolegji vlerëson se edhe pse vendimi për pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë është bërë objekt i ankimit të veçantë dhe gjykatat më të larta kanë dhënë vendim për të, e drejta substanciale që kërkuesja pretendon se është cenuar, në këtë rast e drejta e pronës, është e tillë që mund të mbrohet përmes procesit gjyqësor të themelit, i cili është duke u zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe që ende nuk ka një vendim përfundimtar. Për rrjedhojë, vendimi i kundërshtuar për pranimin e kërkesës së palës tjetër ndërgjyqëse për sigurimin e padisë nuk ka atë masë autonomie nga procesi i themelit, duke mos qenë një procedurë e veçantë, e ndarë ky i fundit. Nga ana tjetër, sipas përmbajtjes së dispozitave procedurale të zbatueshme në rastin konkret, palët në gjykim kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës që shqyrton mosmarrëveshjen ndërmjet tyre, në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, gjersa vendimi bëhet përfundimtar, me kërkesa të reja për ndryshimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit të padisë, kur gjykata e ka pranuar një të tillë. Në këtë kuptim, kërkuesja ka mundësinë për të kërkuar në gjykatat e zakonshme ndryshimin dhe zëvendësimin, ose heqjen e masës në përputhje me këto parashikime.

15. Në kushtet kur kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

16. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk i plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.